

VEPËR KULMINANTE ME VLERË SHKENCORE PËR STUDIMET DHE KRITIKËN HISTORIOGRAFIKE SHQIPTARE DHE JO VETËM

**(Akademik Ali Hadri, “*Studime dhe kritikë historiografike*”, Instituti i
Historisë “Ali Hadri”, Prishtinë 2023, 338 f.)**

Botimi i veprës “**Studime dhe kritikë historiografike**” që doli nga shtypi me rastin e shënimit të 36-vjetorit të shkuarjes në amshim të akademik Ali Hadrit, pa dyshim është jo vetëm një e arrirë e madhe për Institutin e Historisë, por është edhe një e arrirë për shkencën e historisë dhe kritikën historiografike në përgjithësi. Me këtë rast nuk mund të mos përmendet edhe fakti se një iniciativë e kahershme për botimin e dorëshkrimeve të profesor Hadrit, tani po jetësohet, për çka Drejtoria e Institutit meriton çdo lëvdatë, sepse po e kryen një obligim madhor jo vetëm ndaj themeluesit të Institutit të Historisë, por edhe ndaj doajenit të shkencës së historisë e të historiografisë shqiptare e mbi të gjitha ndaj mjeshtrit të kritikës e polemikës shkencore të Kosovës dhe më gjerë.

Ky vëllim që po promovohet sot, përfshinë vetëm disa nga studimet shkencore, kritikën dhe polemikën të cilat akademik Ali Hadri i shkroi në një kohë të pakohë, pra në një kohë shumë të rëndë jo vetëm për vetë autorin, por edhe për gjithë popullin shqiptar në Kosovë e më gjerë - fatin e të cilit e ka ndarë edhe ai vetë. Në këtë periudhë ai u përjashtua nga procesi mësimor në Universitet dhe nga të gjitha funksionet profesionale, për t’u dërguar dhunshëm në pension të parakohshëm dhe i ishte nënshtruar përndjekjes profesionale e personale nga ana e regjimit serb e jugosllav.

E veçanta e këtyre studimeve, kritikave dhe polemikave, të cilat po i ofrohen opinionit të gjerë lexues dhe studiuesve, qëndron në faktin se për herë të parë në një publikim shkencor që ndërmerret nga Instituti i Historisë,

institucion ky që me krenari e mban emrin e akademik Ali Hadrit, po publikohen në një vëllim të veçantë, ku pjesën më të madhe të këtyre punimeve autori e kishte shkruar në gjuhën serbo-kroate për t'iu kundërvënë aty për aty propagandës antishqiptare të autorëve shovinistë serbë. Me rastin e këtij botimi, nën përkujdesjen e redaksisë, punime që kanë qenë në gjuhën serbo-kroate janë përkthyer dhe përshtatur me mjeshtri e përkushtim në gjuhën shqipe nga mr. Shefqet Riza, të cilin edhe me këtë rast redaksia e falënderon.

Vepra “**Studime dhe kritikë historiografike**”, që po e shef dritën, përveç parathënies ka edhe katër kapituj që janë: I. *Monografi*; II. *Studime historike*; III. *Kritikë historiografike*; dhe IV. *Kundërshtime, polemika dhe shkrime*, si dhe treguesin e emrave. Kapitulli i parë përmban një shkrim monografik me titull: “*Pseudoshkenca është e dëmshme*”, që akademik Ali Hadri e ka përgatitur si libër të veçantë në formë sinteze dhe e ka lënë në dorëshkrim të regjistruar në Bibliotekën e Institutit të Historisë. Kjo vepër është një studim kritik e sintetik historiografik që përfshinë rrjedhat historike të popullit shqiptar nga parahistoria, antika, mesjeta, koha e re deri te koha më e re. Ky studim voluminoz është shkruar i nxitur me qëllim të kundërvënies ndaj përpjekjeve joshkencore dhe shoviniste të historiografisë serbo-jugosllave për shpërfytyrimin dhe nëpërkëmbjen e historisë kombëtare shqiptare. Çështjet themelore që shtjellohen në këtë studim historik janë: shteti ilir, luftërat çlirimtare të Gjergj Kastriot-Skënderbeut dhe organizimi shtetëror gjatë mesjetës, Lëvizja Kombëtare Shqiptare dhe relacionet me popujt fqinj, Pavarësia e Shqipërisë, pozita e rëndë diskriminuese e popullit shqiptar në Jugosllavi ndërmjet dy luftërave botërore, kontributi i shqiptarëve të Kosovës në Luftën e Dytë Botërore dhe formësimi i entitetit politik të Kosovës së pasluftës.

Në kapitullin e dytë që titullohet “*Studime historike*” përfshihen studime të shumta historike, të cilat profesor Hadri i ka shkruar gjatë periudhës kur ishte i atakuar dhe anatemuar nga pushteti serb, si personalitet shkencor, si profesor dhe si intelektual shqiptar. Qëllimi ishte të goditeshin jo vetëm rezultatet e historiografisë së Kosovës, të cilës ia kishte vënë themelet akademik Ali Hadri, por edhe të kontestohet legjitimiteti i krijimit të bazës juridike të statusit politik të Kosovës si entitet i veçantë që në atë kohë matej nga pjesëmarrja ose mospjesëmarrja e shqiptarëve në luftën antifashiste. Po

ashtu, tentohej që me shkrime joshkencore, të mbushura me nacionalizëm e shovinizëm antishqiptar të frikësohej profesor Ali Hadri dhe jo vetëm ai, të paralizohej e të anatemohej, sepse ishte halë në sytë e pseudoshkencëtarëve serbë e jugosllavë. Por, përkundrazi ai shquhej për guximin profesional dhe personal, qëndroi stoik në pikëpamjet e tij shkencore, intelektuale, kombëtare e humane deri në frymën e fundit të jetës.

Në këtë kuadër po veçojmë punimet që me këtë rast disa publikohen për herë të parë, sikurse: pasqyrë e shtrembëruar e historisë; antishqiptarizmi i Çubrilloviqit; interpretim dhe vlerësim pseudoshkencor i historisë së LNÇ-së në Kosovë dhe Dukagjin; zhvillimi kombëtar dhe politik i shqiptarëve në Jugosllavi dhe për përdorim të lirë dhe të barabartë të flamurit autentik kombëtar të popullit shqiptar.

Kapitulli i tretë, që titullohet “*Kritikë historiografike*” përfshinë shkrimet kritike historiografike të profesor Ali Hadrit lidhur me qëndrimin e historiografisë serbe dhe të pushtetit serb për historinë e popullit shqiptar, rolin dhe pozitën e shqiptarëve në ish-Jugosllavi dhe analizën e rezultateve historiografike shqiptare e ballkanike. Punimet që përfshihen në këtë kapitull janë: paraqitja e shtrembëruar e historisë; pseudoshkenca e Bogdanoviqit në shërbim të nacionalizmit; shpërfytyrimi i historisë; dhuna mbi historinë dhe pasqyrë e pasaktë e historisë.

Vlen të potencohet se punimi qendror në këtë kapitull është “*Paraqitja e shtrembëruar e historisë*”, që njëherit është polemika e akademik Ali Hadrit e drejtuar kundër shkrimeve e tezave tendencioze të Dimitrije Bogdanoviqit, lidhur me shqiptarët dhe lëvizjen kombëtare të tyre. Si shumë shkrimeve të tjera të akademik Ali Hadrit edhe ky studim nuk u botua për shkak të censurës që iu nënshtroheshin shkrimet e studimet e historianëve shqiptarë e veçanërisht ato të profesor Hadrit.

Përndjekja dhe persekutimi shtetëror serb e jugosllav ndaj akademik Ali Hadrit dhe ndaj historiografisë shqiptare të Kosovës, është tematika kryesore e kapitullit të katërt të titulluar “*Kundërshtime, polemika dhe shkrime*”. Në të përfshihen shkrime, reagime, letra të hapura, ankesa të shumta drejtuar opinionit publik dhe institucioneve shtetërore e partiake serbo-jugosllave e kosovare. Këtu përfshihen vetëm disa nga reagimet e kundërshtimet e një historiani e intelektualit të revoltuar që edhe pse i vetëm me sukses sfidoi fushatën anatemuese antishqiptare serbe e jugosllave ndaj kombit shqiptar

dhe historisë së tij. Edhe pse i vetëm ai me sukses i bëri ballë një makinerie të tërë të një shteti totalitar siç ishin Serbia dhe Jugosllavia me disponim armiqësor ndaj shqiptarëve, historisë dhe inteligjencës kombëtare të tij.

S'ka dyshim se akademik Ali Hadri me opusin e tij krijues është një nga figurat më të rëndësishme të jetës intelektuale e akademike shqiptare të gjysmës së dytë të shekullit XX, sidomos në fushën e historisë dhe të historiografisë. Për këtë dëshmojnë veprat e shumta monografike, tekstet mësimore, studimet shkencore, reagimet, polemikat dhe kritikrat, si dhe artikujt e shumtë të botuar e të pabotuar, që kanë mbetur në dorëshkrim në një periudhë prej tri dekadash, ku trajtoi me akribi shkencore historinë dhe fenomenet shoqërore e politike të shqiptarëve dhe të Kosovës që nga parahistoria e antika e deri në ditët tona. Kjo begati shumëdimensionale paraqet trashëgimi jashtëzakonisht të rëndësishme për historinë dhe kulturën tonë kombëtare. Gjithashtu profesor Hadri posaçërisht shquhet për reagimet, polemikat dhe shkrimet e guximshme kritike kundër historianëve, pseudohistorianëve e historiografisë dhe pseudoshkencës shoviniste serbe. Në kohë të vështirë për Kosovën dhe shqiptarët ai po thuhet se i vetmi që pati guximin intelektual t'u kundërvihet me argumente shkencore pseudoshkencëtarëve shovinistë serbë që ishin ngritur padrejtësisht kundër popullit shqiptar në përgjithësi dhe kundër Kosovës dhe popullit të saj në veçanti.

Në këto shkrime lexuesi i vëmendshëm lehtë do të konstatojë se atakimet dhe kritikrat subjektive, reagimet, vërejtjet e qortimet dhe pakënaqësitë ndaj studimeve dhe veprimtarisë shkencore të Ali Hadrit fillojnë që në vitet e '60-ta, të shekullit të kaluar e vazhduan kohë pas kohe me ngritje e rënie varësisht nga klima politike që mbretëronte në shoqërinë kosovare të kohës, për të arritur kulmin pas Demonstratave të vitit 1981. Si intelektual konsekuent e patriot *par excellence* Ali Hadri nuk pranoi të instrumentalizohet në fushatën politike antishqiptare pas vitit 1981, siç bëri një pjesë e inteligjencës së atëhershme për karrierë. Edhe pse u kërcënua edhe me likuidim fizik, për të vazhduar me ndjekjet, akuzat, mohimin, linçimin e veprës dhe personalitetit të tij nga udhëheqës politikë e shtetërorë, fatkeqësisht edhe nga akademikë, profesorë e pseudohistorianë të Prishtinës e Beogradit, ai kurrë nuk u dorëzua, por mbeti konsekuent e stoik, siç u ka hije intelektualëve dhe atdhetarëve të vërtetë. Ali Hadri, përkundrazi edhe

pasi e përjashtuan me dhunë nga puna në Universitetin e Prishtinës dhe nga institucionet shkencore, ai nuk pushoi së shkruari e së kontribuari për të pasqyruar të vërtetën, të shkuarën dhe të ardhmen dhe historinë e popullit të vet duke kontribuar kështu sidomos në zhvillimin e kritikës shkencore historiografike të shqiptarëve në përgjithësi dhe të Kosovës në veçanti.

Të qëndroje vertikalisht në një kohë kur kërcënoheshin, mohoheshin, ndaloheshin e anatemohehin publikisht, historia dhe e kaluara e popullit shqiptar nga i tërë mekanizmi shtetëror e politik i kohës, ishte shumë vështirë, madje këtë mund ta bënin vetëm burra e intelektualë të mëdhenj e të fortë të kombit. Në mesin e këtyre personaliteteve më i merituari dhe ai që e ngriti dhe e lartësoi flamurin e qëndresës pa dyshim ishte vetë akademik Ali Hadri. Ai edhe pse u shua dhe kaloi në amshim, mbeti në kujtesën tonë si një yll që rrezatonte gjithnjë në panteonin e lirisë. Ali Hadri me punën dhe qëndrimet e tij jo vetëm që shkroi dhe ia vuri themelet historiografisë sonë, por edhe bëri histori me faktin se fatin e vet e ndau me fatin tragjik të popullit që i takoi e me punën dhe vlerat prej eruditi shënoi kohën në të cilën jetoj dhe veproi duke i dhënë vullë dhe duke na lënë një trashëgimi të jashtëzakonshme si pjesë e vlerave universale njerëzore.

Gjatë leximit të kësaj përmbledhjeje punimesh e kritikash lexuesi do të gjejë vetëm një pjesë të reagimeve, kritikave dhe polemikave që i shkroi Ali Hadri pas largimit nga Universiteti dhe nga institucionet që kishte pas ndonjë pozitë. Ai me sukses do të përgjigjej kundër interpretimeve arbitrare dhe shtrembërimeve flagrante që i bëheshin historisë së popullit shqiptar dhe sidomos asaj të Kosovës nga historianët e vjetër e të rinj shovinistë serbë e jugosllavë. Këto vepra janë edhe trashëgimi dhe testament i përshkrimit të situatës politike, fushatës për degradimin e pozitës kushtetuese të Kosovës dhe shkeljeve flagrante të të drejtave kombëtare dhe humane të popullit shqiptar në Kosovë dhe më gjerë.

Është me rëndësi të potencohet edhe fakti se objekt i këtij botimi janë shumë probleme historiografike të cilat historiografia dhe historianë, publicistë e gazetarë tendenciozë serbë e jugosllavë jo vetëm që nuk i trajtonin dhe shpjegonin drejt e mirë, por me qëllim të paracaktuar i shtrembëronin, për t'u vënë në shërbim të politikës ditore të hegjemonisë serbomadhe. Në këtë botim lexuesi dhe studiuesi i vëmendshëm do të gjejë interpretimet shkencore të profesor Hadrit që i kundërvihen tezës serbe, ku njihet vetëm

karakteri fisnor i organizimit të shoqërisë ilire dhe jo më tepër. Mbi bazën e të dhënave dhe të argumenteve shkencore jo vetëm nga arkeologjia dhe historiografia shqiptare, por edhe nga ajo serbe, përkatësisht jugosllave, ai argumentoi katërçipërisht ekzistencën e shteteve ilire. Pika qendrore e argumentimit të tij shkencor lidhur me periudhën antike të Ilirikumit ka qenë dhe është vazhdimësia iliro-shqiptare dhe rrjedhimisht jo vetëm lashtësia, por edhe autoktonia e shqiptarëve në trojet ku ata kanë banuar gjatë shekujve dhe ku banojnë edhe sot. Në shkrimet e tij Ali Hadri tezën serbe që e mohonte autoktonin shqiptare e quante antihistorike, prandaj ai ishte kundërshtues i fortë i politikës denigruese e hegjemoniste serbe, e cila përpiqej që shqiptarët e Kosovës t'i paraqiste të ardhur në trojet e sotme stërgjyshërore të tyre.

Me këtë rast me të drejtë mund të konstatojmë se me veprat dhe punimet e studimet shkencore që na ka lënë trashëgim, akademik Ali Hadri zë vend të merituar në mesin e historianëve të mëdhenj që jo vetëm e studiuan dhe e shkruan historinë e popullit tonë, por edhe që kanë nxjerrë mësim prej saj kanë formësuar bindje të qëndrueshme të gjeneratat e reja qoftë për të kaluarën, qoftë edhe për të tashmen dhe për të ardhmen e popullit shqiptar dhe trojeve të tyre të pakontestueshme shekullore. Si intelektual me plot kuptimin e fjalës dhe si shkencëtar *par excellence* për të vërtetën shkencore, ai mbetet emër i pavdekshëm dhe frymëzim i përhershëm për historinë dhe historiografinë shqiptare e më gjerë, por edhe sinonim i guximit intelektual për mbrojtjen e të drejtave të popullit të tij.

Vepra **“Studime dhe kritikë historiografike”** e akademik Ali Hadrit, s'ka dyshim se është kontribut i padiskutueshëm për shkencën e historisë në përgjithësi, por edhe për kritikën historiografike në veçanti. Botimi i kësaj vepre nga Instituti i Historisë, është një eveniment me rëndësi jo vetëm për studiues e studentë të historisë në përgjithësi e të historisë së popullit shqiptar në veçanti, por edhe për një shtresë shumë më të gjerë lexuesish e studiuesish, aq më tepër kur kihet parasysh edhe fakti se botime të tilla na mungojnë.

Krejt në fund përgëzojmë Institutin e Historisë për iniciativën dhe angazhimin rreth botimit të veprave të akademik Ali Hadrit duke i uruar suksese të reja në realizimin e projekteve shkencore me të cilat do të ndriçohet edhe më tej e kaluara jonë historike.

Fehmi REXHEPI